

VENDIM
Nr. 535, datë 25.7.2019

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE DHE TË VEPRAVE NDIHMËSE NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE TOPOJË, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA “MAX
ENERGY”, SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe të veprave ndihmëse në njësinë administrative Topojë, qarku Fier, nga shoqëria “*Max Energy*”, sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) Emri i aplikuesit: “*Max Energy*”, sh.p.k.;
- b) NIPT/NUIS i aplikuesit: L77003205H;
- c) Tipi i centralit: eolik;
- ç) Kapaciteti i instaluar: 3 MW;
- d) Numri i njësive gjeneruese të burimit gjenerues të energjisë dhe kapaciteti i tyre në MW: 1 (një) turbinë me kapacitet 3 MW;
- dh) Afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 24 muajve, nga marrja e lejes së ndërtimit;
- e) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: njësia administrative Topojë, qarku Fier;
- ë) Afati i miratimit të ndërtimit: 48 muaj nga hyrja në fuqi e këtij miratimi;
- f) Koordinatat e tokës: sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
- g) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucione të tjera të autorizuar prej saj kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synimin që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionit të projektit;
- gj) Shoqëria “*Max Energy*”, sh.p.k. ka detyrimin që:
 - i) të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;
 - ii) të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprahe mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii) të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë “*Max Energy*”, sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj;
 - iv) t’i japë falas, në formë *royalty*, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë sasinë e energjisë elektrike (por jo më të vogël se 2% të sasisë vjetore të prodhimit ose konvertimin e saj në vlerë). Në rast konvertimi në vlerë monetare, këto të ardhura derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit;
 - v) të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1

Koordinatat e tokës

Shoqëria “MAX ENERGY”, sh.p.k. është pajisur me një kontratë qiraje për një tokë pa frut (ranishte), me sipërfaqe të përgjithshme 37 300 m², e ndodhur në fshatin Sheq Marinas, njësi administrative Topojë, qarku Fier, me numër pasurie 286/5, zona kadastrale 3358, volum 10, faqe 85, me kufizime nga veriu me pasurinë 561, nga lindja me pasurinë 565, nga jugu me pasurinë 286/6 dhe nga perëndimi me pasurinë 363, me koordinata si më poshtë:

X	Y
363446.530	4517253.923
363926.088	4517253.923
363446.530	4516857.048
363926.088	4516857.048

